



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 852/ Prot.

Durrës, më 11.03.2025

VENDIM

Nr 23, datë 11.03. 2025

PËR

"RIORGANIZIMIN MBI MASËN 20% TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER I SHKENCAVE NË "MËSUESI, GJUHË E HUAJ, GJUHË GJERMANE" NË PROGRAM TË PËRBASHKËT (DIPLOMË E DYFISHTË) NDËRMJET UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS DHE UNIVERSITETIT "CONSTANTINE THE PHILOSOPHER", NITRA, SLOVAKI (UKF).

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 3 e kreut IV/A; në Statutin e UAMD-së; Rregulloren e UAMD-së; Vendimin e Senatit Akademik Nr. 13, datë 30.01.2024; si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 849 prot., datë 11.03.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Riorganizimin mbi masën 20% të programit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Mësuesi, gjuhë e huaj, Gjuhë Gjermane" në program të përbashkët (diplomë e dyfishtë) ndërmjet Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe Universitetit "Constantine the Philosopher", Nitra, Sllovakia (UKF), bazuar në pikën 3 kreu IV/A, të Udhëzimit të MAS Nr. 2, datë 21.01.2025, bëhen cilësimet si më poshtë:
 - a) Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën gjermane dhe në gjuhën angleze;
 - b) Kodi i programit të studimit **P-72MS-0231-GA.**

2. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

